

REHABILITIMI I SHKOLLES SE MESME „GJERGJ PEKMEZI“ POGRADEC

RELACION ARGUMENTIMI

Shkolla e mesme e pergjithshme "Gjergj Pekmezi" ndodhet ne pjesen lindore te qytetit, në lagjen nr 1, rruga e "Korçes". Eshte nje nga shkollat e mesme qe eshte hapur ne vitet 1980 ne Pogradec.

Karakateristika te gjendjes egzistuese

Shkolla

- numri i pergjithshem i nxenesve 640
- numri I klasave 22
- numri I personelit 42
- numri I banjave WC per nxenesit 12
- numri I banjave WC per personelin (3 femra,3 meshkuj)
- nuk ka ambiente te pershtatshme per laborator kimie
- nuk ka ambiente per programe sportive .
- sistemi i ngrohjes qendror (funksionon por ka mprobleme)
- sistemi i elektrik (funksionon por ka mprobleme)

Te dhena teknike

Kjo shkolle eshte ndertuar ne vitet 1980

Gjate kesaj kohe jane realizuar rregullime te pjeseshme te godines

-Shkolla perbehet nga nje godine 4 kat siperfaqe ndertimi 720 m2

Nga ana konstruktive godina eshte realizuar sistem te perzier tra kolone dhe mur tulle 38 cm dhe 25 cm.

Rezultatet e anketimit ,te prinderve,nxenesve e mesuesve dhe aktoreve te tjere si dhe te dhenat e dy vleresimeve “Vleresimi fizik i objektit”dhe “Vleresimi sipas standarteve”,japin listimin e meposhtem ,sipas renditjes,te nevojës per investim

1. Hidrohizolim i tarraces (ose ndertim cati e re)
2. Dyer e dritare te reja
3. Ambjente te reja sportive
4. Rikonstruksion i banjove
5. Sistemimi i oborrit te jashtem
6. Ndertimi i terreneve sportive
7. Shtrim me pllaka ,suvatim e lysterje
8. Sistemi elektrik
9. Sistemi i ngrohjes
10. Rikonstruksion i fasades
11. Rregullimi i Rrethimit te shkolles
12. Ambjente per laboratore etj.

-Sistemi i ngrohjes

Sistemi ekzistues eshte I perbere nga rrjeti qendror (Tuba çeliku me diameter deri ne 75 cm) dhe rrjete dytesore te dimensioneve deri ne 2”

Sistemi i ngrohjes eshte funksional por me problematika te shumta ne rrjet.

Struktura mbuluese

Mbulesa eshte e realizuar tarrace me solete betoni dhe shtresa H/izoluese.Si rezultat i materialeve te perdorura H/izoluese dhe amortizimit te tyre kohor dhe atmosferik ka humbur funksioni per te cilen jane ndertuar dhe rezulton me pikime dhe rrjedhje uji ne tavanet e katit te kater dhe te mureve perimetrale.Gjithashtu sistemi i grumbullimit dhe

largimit te ujrave (ulluket) eshte jashte standartit dhe jashte funksionit.Kjo shtrese mbuluese nuk realizon termoizolimin per ambientet te cilat mbulon ,duke krijuar kondesime te lageshtise.

-Shtresat

Shtresat ne pegjithesi shtresat e dysHEMEVE te KORIDOREVE dhe disa ambienteve te tjera jane te realizuara me pllaka te konsumuara nga koha,te plasaritura,te thyera dhe te shkeputura.

-Suvatimet e brendeshme dhe te jashtme

Per shkak te problemeve të hidro dhe termohizolimit me pasoje krijimin e lagështisë dhe ftohtësisë te vazhdueshme në ambientet poshtë strukturës mbuluese jane shkaktuar dëmtime te konsiderueshme te suvatimeve në mure e tavane si dhe demtime te theksuara ne fasada.Suvatimet ne korridore dhe banjo jane demtuar dhe nga faktori njeri.

Dyer dritare

Gjendja fizike e tyre rezulton:

Dritaret jane pjeserisht prej druri dhe duralumini ,kurse dyert jane prej druri .Te gjitha kane probleme ne hapje –mbyllje dhe ne qendrueshmeri.

Sistemime të jashtme

Territori i ka nje siperfaqe 2200 m2 ne te cilen 760 m2 eshte si shesh per reshtim, 570 m2 terrene sportive , dhe 150 m2 siperfaqe e gjelberuar, Ky territor eshte i rrethuar. Muri rrethues dhe rrethimi eshte i demtuar .

-Oborri,rruget dhe sheshet janë në gjendjen e tokës natyrale të perbaltur vazhdimisht në kohë reshjesh dhe plot pluhur në kohë të thatë. Ne te njejten gjendje jane dhe terrenet sportive. Persa i perket gjelberimit ai eshte spontan dhe I pa sistemuar

-Pra ambientet me të cilat nxenesit marin kontaktin e parë me shkollën nuk janë aspak edukativë dhe funksionalë.

Mbështetur në analizen e mësipërme rehabilitimi synon të realizojë :

- Tarraca ekzistuese për vetë problemet që paraqet dhe për kushtet klimaterike të zonës, rikonstruhet duke ndërtuar mbi të një strukturë çatie të thjeshtë me tregulla importi, nëpërmjet të ciles realizohet një H/izolim pa probleme në mbajtje dhe një termoizolim efikas.
- Suvatimin e mureve e tavane në klasat dhe në pjesët e holleve dhe koridoreve të gjithë shkollës
- Suvatim i jashtëm me termoizolim për uljen e humbjeve të nxehtësisë dhe rregullimin estetik të objektit
- Shtresa të reja pllakash për arsye të demtimit të atyre ekzistuese.
- Ndërtimin e një ambienti sportiv
- Rikonstruksionin e nyjeve sanitare dhe të reja në varesi të numrit të nxënësve (vajza, djem)
- Rikonstruksionin e elementeve të lëvizjes (dyer të jashtme, shkallë e koridore)
- Sistemin e ngrohjes
- Rrjetin elektrik, telefonik dhe interneti

- Sistemit e jashtëm synojnë në:

- rehabilitimin dhe përmirësimin e elementeve rrethues dhe elemente të tjera dekorative
- disiplinimin e hyrjes së nxënësve në shkollë nëpërmjet hyrjeve të kontrolluara.
- Krijimin e terreneve sportive fushe volejbolli, basketbolli, mini futbollit, vegla gjimnastike.
- Trajtimi me shtresë pllaka betoni dekorative të shesheve

- Krijimi i sipërfaqeve të gjelberuara për kalimin e kohës të pushimit
- Ndertimin e rrjetit për largimin e ujrave sipërfaqore k.u.b dhe k.u.z

Si rezultat i kësaj ndërhyrje arrihet:

- Imazhi me i mire i shkolles
- Ambjente e brendshme të shkolles do rregullohen
- Kushte me të mira mesimi
- Ambjente sportive e palester me kushte për zhvillim aktiviteti etj.

GRUPI I PROJEKTIMIT

Ing. T BUZO

Ark. Dh.GJATA